



REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
KOMUNA MITROVICA E VERIUT OPSTINA SEVERNA MITROVICA MITROVICA NORTH MUNICIPALITY	
Njesia Org. Org. Jedit Org. Unit:	03
Nr. Prot. Br. Pro Prot. Nr.	03-0201-006976/24
Nr. i faqeve Br. stranice No. pages	27
Data Datum Date	17/06/2024

REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës Veriore
Opština Severna Mitrovica – Municipality of Mitrovica North

DREJTORIA PËR BUXHET, FINANCA DHE ZHVILLIM EKONOMIK

DATË/A:	14.06.2024
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Komitetin për Politikë dhe Financa/Kuvendin Komunal z. Nedžad UGLJANIN – Kryesues
KOPJE :	Kryetarit të Komunës z. Erden ATIQ - Kryetar
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Drejtoria për financa dhe zhvillim ekonomik znj. Mevlyde PEÇI-SHALA - Drejtore
NGA/OD/FROM:	Drejtoria për financa dhe zhvillim ekonomik znj. Albina SYLA MUSTAFA – Udheheqes i sektorit për buxhet dhe financa / ZKF
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Korniza Afatmesme Buxhetore – Komunale 2025-2027

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit si dhe Qarkores Buxhetore 2025/01, Organizata Buxhetore obligohet që të pregadit Kornizën Afatmesme Buxhetore - Komunale 2025–2027, në bashkëpunim me drejtorët e Drejtorive komunale. Tani po e procedojmë në Komitet për Politikë dhe Financa për shqyrtim e më pas edhe në Kuvend Komunal, për diskutim dhe aprovim. Drejtoria për Financa dhe Zhvillim Ekonomik, obligohet që një kopje ta dorëzoj në Departamentin e Buxhetit Komunal në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve, jo më vonë se më 30 Qershor 2024.

Bashkëngjitur e gjeni:

Kornizën Afatmesme Buxhetore - Komuale 2025-2027.

Me respekt !



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës Veriore

Opština Severna Mitrovica – Municipality of North Mitrovica

KORNIZA AFATMESME BUXHETORE

2025 - 2027

Qershor 2024

PËRMBAJTJA

KORNIZA AFATMESME BUXHETORE KOMUNALE 2025 – 2027	3
OBJEKTIVAT E KOMUNËS SË MITROVICËS VERIORE :.....	4
OBJEKTIVAT E QEVERISË SË KOSOVËS :.....	5
OBJEKTIVAT DHE PËRFITIMET E PROCESIT TË KASH-IT PËR KOMUNAT	5
VEPRIMET QË KANË TË BËJNË ME OBJEKTIVAT:	9
PJESËMARRJA E GRANTEVE NË TOTALIN E BUXHETIT KOMUNAL SIPAS VITEVE 2025 – 2027 -Tabela 1	10
GRAFIKU : PJESËMARRJA E GRANTEVE NË FINANCIMIN E BUXHETIT KOMUNAL 2025 SIPAS QARKORES BUXHETORE 2025/01	10
PLANIFIKIMI I TË HYRAVE VETANAKE KOMUNALE	11
PLANIFIKIMI I TË HYRAVE VETANAKE KOMUNALE 2025 – 2027 -Tabela 2.....	12
PARAQITJA GRAFIKE E TË HYRAVE VETANAKE NË KAB- KOMUNAL SIPAS VITEVE 2025 – 2027	13
VLERËSIMET E HERËSHME TË SHPENZIMEVE TË PROGRAMEVE BUXHETORE -Tabela 3.....	13
GRANTET QEVERTARE DHE TË HYRAT VETANAKE KOMUNALE 2025 – 2027 – TABELA 4..	15
ZYRA E KRYETARIT	17
ZYRA E KUVENDIT KOMUNAL.....	18
DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME	19
DREJTORIA PËR FINANCA , BUXHET DHE ZHVILLIM EKONOMIK.....	20
DREJTORIA PËR SHËRBIMEVE PUBLIKE , INFRASTRUKTURË , INSPEKSION DHE SITUATA EMERGJENTE	21
NJËSIA E ZJARRFIKËSVE.....	22
DREJTORIA PËR URBANIZEM , KADASTËR DHE GJEODEZI.....	23
DREJTORIA PËR ARSIM , KULTURË , RINI DHE SPORT.....	24
DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE SHERBIME SOCIALE.....	25
DREJTORIA PËR KOMUNITETE LOKALE DHE KTHIM	26

KORNIZA AFATMESME BUXHETORE KOMUNALE 2025 – 2027

Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale e Mitrovicës Veriore, është dokument bazik i nivelit të lartë strategjik komunal që do të pasqyroj caqet e përgjithshme të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore si dhe strukturën përkatëse sipas kategorive ekonomike, për të përmbushur objektivat e përcaktuara me strategjinë zhvillimore afatmesme komunale. Si pjesë përbërëse e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) të Kosovës, është e përpiluar në përputhje me procedurat buxhetore 2025/2027, të dhëna nga MFPT (Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve) përmes Qarkorës Buxhetore 2025/01 për Komunitat të lëshuar me datën 15.05.2024.

KAB promovon rritjen e mirëqenies sociale përmes zgjerimit dhe ngritjes së cilësisë, ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare, me fokus të veçantë në grupet në nevojë dhe barazinë gjinore. Në këtë dokument i kemi kushtuar rëndësi planifikimit të buxhetit nga aspekti i barazisë gjinore. Korniza afatmesme buxhetore (KAB) komunale paraqet një mjet të procesit për zhvillimin e buxhetit duke marrë për bazë nevojat e grave dhe burrave, që bënë ndërlidhjen e resurseve në dispozicion me prioritetet e komunës, duke u bazuar në qëndrueshmërinë e programeve komunale gjatë periudhës së ardhshme tri vjeçare. Çdo program buxhetor është trajtuar me kujdes për plotësimin e nevojave dhe kërkesave me komponentë të ndjeshme gjinore. Me Kornizën afatmesme buxhetore – komunale, do të paraqesim shpjegimet e politikave dhe prioritetëve të tanishme dhe afatmesme të Komunës së Mitrovicës Veriore si dhe projeksionet lidhur me mënyrën me të cilën buxheti i Komunës do të përmbush dhe përkrah projektet me prioritet, që do të përcaktohen sipas buxhetit për vitet 2025 – 2027 gjithnjë duke u bazuar në :

Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal

Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit

Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale

Ligjin për Kufijtë Administrativ Komunal dhe

Ligji i buxhetit.

Korniza Afatmesme Buxhetore për vitin 2025 – 2027 planifikohet në bazë të Buxhetit, i cili bazohet në buxhetin e programeve dhe është i bazuar në objektivat dhe në deklaratat e misionëve të programeve. KAB-i komunal 2025–2027 është krijuar në përputhje me udhëzimet e Qarkores Buxhetore nr. 2025/01 e cila sfond të vetin dhe kontekst ka prioritetet e programeve dhe kursimet e shpenzimeve. Në KAB Komunal paraqiten edhe deklaratat dhe misionet e programeve dhe nënprogrameve buxhetore lidhur me punën e tyre pasuese tri vjeçare.

Në secilën fazë të planifikimit të buxhetit 2025-2027 do të mirren parasysh kërkesat e qytetarëve, grupeve të interesit, ku do të përfshihen problemet e burrave dhe grave me qëllim të përmbushjes së kërkesave të tyre dhe rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

MISIONI:

Rritja e mirëqenies qytetare duke iu ofruar shërbime sa më të shpejta dhe cilësore duke u bazuar në zgjidhjen e problemeve të tyre me të cilat ballafaqohen qytetarët (gratë dhe burrat).

OBJEKTIVAT E KOMUNËS SË MITROVICËS VERIORE :

- Mbrojtja, përmirësimi i ambientit dhe infrastrukturës së qytetit me rregullimin dhe asfaltimin e rrugëve në qytet dhe periferinë e komunës tonë, zgjerimin e rrjetit të ndriqimit publik me mundësi të barabarta në rritjen e sigurisë së grave.
- Zbatimi i planit zhvillimor komunal dhe hartimi i planeve rregullative në zonat urbane si dhe hartat zonale.
- Parandalimi (preventiva), edukimi shëndetësor, promovimi i shëndetit dhe këshillimi shëndetësor, imunizimi dhe vaksinimi, shërbimi shëndetësor urgjent 24 orë, shërbimet e shëndetit oral, kujdesi për shëndetin mendor bazuar në bashkësi, kujdesi shëndetësor riprodhues dhe metoda e planifikimit familjar, vizitat shtëpiake për shtatzëna, nëna të reja dhe fëmijë si dhe për kujdesi shëndetësor paliativ.
- Përfshirja e vajzave dhe djemve në arsim parashkollor, fillor dhe të mesëm si dhe ngritja e nivelit të arsimit.
- Krijimi i kushteve për zhvillimin e aktiviteteve sportive për djemtë dhe vajzat me funksionalizimin e sallave sportive, zhvillimin e kulturës përmes shfaqjeve me premiera dhe reprizave si dhe përmes subvencionimit të projekteve përmes OJQ-ve për vitet 2025-2027 ku 50% do të shfrytëzohen burrat/djemtë dhe 50% gratë/vajzat.
- Përkrahja e të rinjve përmes START-UP biznese ku do të shfrytëzohen 60% për vajza/gra dhe 40% djem/burra.

- Lehtësimi i procedurave për ofrimin e shërbimeve administrative përmes përdorimit të e-kiosqeve me mundësi të barabarta për të gjithë dhe komunitetin me nevoja të veçanta.

OBJEKTIVAT E QEVERISË SË KOSOVËS :

- Qeverisja e mirë, transparente dhe në shërbim të qytetarëve të Kosovës
- Sundim i rendit dhe ligjit
- Ekonomi të zhvilluar dhe modernizim të shtetit
- Arsimit cilësor me aftësi konkurruese në tregun e BE-së
- Shëndetësi dhe shërbime efektive
- Integritet Euro-Atlantike, anëtarësim në OKB dhe NATO
- Ushtri moderne sipas modelit të NATO-s

OBJEKTIVAT DHE PËRFITIMET E PROCESIT TË KASH-IT PËR KOMUNAT

Inkorporimi i qasjes së KASH në proceset e buxhetit komunal është i motivuar nga qëllimet e mëposhtme:

- Të ofrojë kornizë gjithëpërfshirëse dhe reale për planifikimin dhe realizimin e shpenzimeve buxhetore për tri vitet e ardhshme;
- Të rrisë parashikimin dhe qëndrueshmërinë e planifikimit të buxhetit përmes futjes së parashikimit më të besueshëm të të hyrave vetanake komunale dhe shpenzimeve në perspektivë tre vjeçare;
- Të përmirësojë lidhjen në mes procesit të alokimit të burimeve dhe prioriteteve të politikave komunale;
- Të fuqizohen drejtoritë komunale në shpërndarjen e burimeve, menaxhim dhe shfrytëzim;
- Të bëhet planifikimi sa më objektiv dhe real nëpër kategori ekonomike përmes sistemit – BDMS;

- Të pregaditet Plani i rrjedhës së Parasë së Gatshme për vitin fiskal;
- Të bëhet planifikimi i mjeteve buxhetore për vitet e ardhshme sipas kategorive ekonomike;
- Menaxhimi më efikas i kontratave kornizë – tri vjeqare;
- Planifikimi i Investimeve Kapitale përmes sistemit të PIP-it;
- Përfshirja e buxhetimit gjinor në të gjitha fushat si një implementim i nevojshëm për të garantuar parimin e barazisë gjinore.

Shtimi i efikasitetit dhe efektivitetit

- Përmirësimi i efektivitetit në shpenzimin e buxhetit komunal;
- Planifikimi i buxhetit në kode dhe nënkode ekonomike të shpenzimeve;
- Shfrytëzimi maksimal i burimeve;
- Respektimi i afateve kohore gjatë kryerjes së punëve;
- Respektimi dhe Shpenzimi i buxhetit sipas CASH FLOW;
- Kryerja e punëve në mënyrë të duhur dhe cilësore;
- Përzgjedhja e punëve me prioritet për realizim;
- Respektimi i afatit kohorë të pagesave dhe menjanimi i pagesave direkte nga Thesari.

Kontrolli dhe reduktimi i shpenzimeve

- Implementimi i rekomandimeve të auditorëve të ZKA;
- Evitimi i shpenzimeve të panevojshme;
- Planifikimi i shpenzimeve me kohë;
- Përparësia nga blerja me shumicë;
- Përmirësimi i performancës për mallra dhe shërbime;
- Planet për kursim nga shpenzimet – kontratat kornizë.

Ngritja e kapaciteteve njerëzore

- Trajnimi për burimet dhe resurset njerëzore komunale;
- Përdorim i software-ve të avancuar për shërbime;
- Profesionalizimi i shërbimeve komunale.

Të sigurohet disiplina financiare

- Harmonizim me politikat financiare, ligjet, rregulloret dhe me udhëzimet administrative,
- Ekzistenca e kontrolleve interne – Rekrutimi i Auditorit të Brendshëm dhe implementimi i rekomandimeve,
- Transparenca gjatë sjelljeve të vendimeve, informimi publik,
- Analiza të vazhdueshme dhe sipas kërkesave të shpenzimeve,
- Planifikimi dhe ekzekutimi i Buxhetit sipas planit të rrjedhjes së parasë së gatshme (Kesh Planit),
- Planifikimi dhe realizimi Investimeve Kapitale sipas programit të PIP (Programi Investime Publike),
- Respektimi i Ligjit të Buxhetit - mos hyrja në obligime pa mbulesë - zotim të mjeteve.

Ekonomia

- Zhvillimi i Strategjisë Komunale për promovim ekonomik,
- Krijimi i kushteve të përshtatshme për donatorë të brendshëm dhe të jashtëm,
- Strategjia për zhvillimin e turizmit,
- Strategjia për Biodiversitet.

Shqyrtimi dhe përmirësimi i sistemeve operative dhe transparenca

- Respektimi i procedurave të prokurimit,
- Evidenca e duhur financiare dhe procedurat e kontabilitetit,
- Inventarizimi i duhur dhe menaxhimi i pronës,
- Koordinimet në mes drejtorive – programeve buxhetore,
- Përmirësimi i mbledhjes së të dhënave dhe analizat,
- Menaxhimi i bazës së të dhënave,
- Informimi publik.

Përmirësimi i bazës së të hyrave vetanake komunale

- Rritja e performancës së inkasimit të tarifave dhe taksave komunale,
- Funkcionalizimi i Zyrës së tatimit në pronë,
- Tarifa (ngarkesa) të reja për shërbime të reja,
- Tarifa (taksa) ekonomiksht të arsyetuara,
- Ngarkesa të reduktuara (periodike),
- Rritja e efikasitetit në inkasim të të hyrave vetanake dhe të arkëtueshmeve.

Ristrukturimi organizativ

- Shqyrtimi i strukturës organizative - Organogrami i ri,
- Plotësim ndryshim i Rregulloreve për Organizimin e kompetencave të drejtorive komunale.

VEPRIMET QË KANË TË BËJNË ME OBJEKTIVAT:

- Kontrolli për parandalimin e ndërtimit ilegal të shtëpive dhe objekteve tjera
- Procesi i legalizimit të ndërtimeve pa leje
- Zbatimi dhe respektimi i rregulloreve komunale
- Përgatitja e buxhetit dhe planit të punës për vitin 2025
- Përgatitja e Qarkoreve Interne Komunale
- Mbajtja e Dëgjimeve Buxhetore me qytetarë
- Përgatitja e planeve rregullative dhe detaje
- Përmirësimi i mbledhjes bazike të të dhënave dhe analiza e tyre
- Shqyrtimi i përgjegjësive dhe i obligimeve komunale
- Menaxhimi i projekteve
- Menaxhimi i bazës së të dhënave
- Monitorimi
- Vlerësimi.

Perspektiva e politikave fiskale

Vëmendje të veçantë i kemi kushtuar politikave fiskale, politikës së të ardhurave si nga Granti i Qeverisë, të Hyrave Vetanake komunale, shpenzimeve, ku janë marrë për bazë nevojat e grave dhe burrave gjatë planifikimit, duke filluar nga aspekti i punësimit, participimin në vendim marrje për projektet e ndryshme, kultura, subvencione, pjesëmarrja në dëgjimet publike etj.

Me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2025 - 2027 e cila është aprovuar nga Qeveria e Kosovës, bazuar në prioritetet afatmesme të Qeverisë dhe Kornizës Makro – Fiskale për 2025 -2027, Qeveria është përkushtuar që duke e ruajtur stabilitetin fiskal të përkrahë edhe kërkesat e Organizatave Buxhetore duke paraparë ndërmarrjen e një varg masash, që nga kursimet në kategorinë e shpenzimeve operative – si rezultat i rekomandimeve të FMN-së¹ e deri te marrja e masave konkrete në realizimin e të Hyrave në nivel Qendror dhe Lokal si :

Kontroll më efikas dhe mbledhje e detyrueshme për ngarkesat dhe tarifat e mbledhura në nivel lokal.

Sensibilizim i qytetarëve për të kryer obligimet ndaj Komunës.


¹ Fondi Monetar Ndërkombëtar

**PJESËMARRJA E GRANTEVE NË TOTALIN E BUXHETIT KOMUNAL SIPAS
VITEVE 2025 – 2027**

Nr	Fondi Burimor	Planifikimi 2025	Parashikimi 2026	Parashikimi 2027
1	Granti i Përgjithshëm	3,289,654.00	3,475,115.00	3,663,958.00
2	Granti i Arsimit	1,651,532.00	1,701,078.00	1,752,111.00
4	Granti i Shëndetësisë	475,089.00	497,703.00	521,394.00
5	Financimi për Shëndetësi Sekondare	989,935.00	989,935.00	989,935.00
6	Shërbime Rezidenciale	-	-	250,000.00
7	Të Hyrat Vetanake	106,157.00	111,465.00	117,038.00
		6,512,367.00	6,775,296.00	7,294,436.00

Tabela 1

**GRAFIKU : PJESËMARRJA E GRANTEVE NË FINANCIMIN E BUXHETIT KOMUNAL 2025
SIPAS QARKORES BUXHETORE 2025/01**



PLANIFIKIMI I TË HYRAVE VETANAKE KOMUNALE

Të hyrat komunale të komunës së Mitrovicës Veriore realizohen në bazë të Ligjit mbi Financat e Pushtetit Lokal, Rregullorës mbi Tarifat dhe Gjoba Komunale, si dhe dispozitave tjera ligjore, të cilat përcaktojnë llojet e ndryshme të hyrave komunale, me të cilat komuna ka të drejtë të caktoj dhe inkasoj të hyra tjera komunale.

Në mungesë të Zyrës së Tatimit në pronë dhe tokë, të cilën planifikojmë ta funksionalizojmë në vitin 2025, bazë e të hyrave për momentin janë të hyrat nga regjistrimi i automjeteve dhe taksat tjera komunale.

TË HYRAT VETANAKE TË KOMUNËS PËR VITET 2025 – 2027 PARASHIKOHEN TË INKASOHEN KRYESISHT NGA :

- Tatimi në pronë
- Tatimi në tokë
- Taksa për mbeturina
- Taksa për leje ndërtimi
- Taksa administrative komunale
- Taksat për ushtrim të veprimtarisë afariste
- Taksat për lejen për shërbime profesionale
- Taksa për automjete motorike
- Taksa për certifikata
- Qiraja nga objektet
- Participim në Arsim
- Participim në Shëndetësi
- Qiraja e tokës
- Të hyra tjera^{2♦}


^{2♦} Dhëniet nga Donatorët dhe Participimi i qytetareve

PLANIFIKIMI I TË HYRAVE VETANAKE KOMUNALE 2025 – 2027

KOMUNA E MITROVICËS VERIORE		Planifikimi 2025	Planifikimi 2026	Planifikimi 2027
50013	Taksa për Çertifikatë të Lindjes	10,000.00	10,000.00	10,000.00
50015	Taksa për Çertifikatë të Vdekjes	1,000.00	1,000.00	1,000.00
50014	Taksa për Çertifikatë të Kurorëzimit	4,000.00	4,000.00	4,000.00
50016	Taksa për Çertifikata tjera të Gjendjes Civile	20,000.00	20,000.00	20,000.00
50017	Taksa për Verifikim të Dokumenteve të Ndryshme	1,000.00	1,000.00	1,000.00
50107	Gjobat të tjera	1,500.00	1,500.00	1,500.00
50001	Taksa për Regjistrim të Automjeteve	20,000.00	20,000.00	20,000.00
50009	Taksa Komunale për Leje Ndërtimi	5,000.00	5,000.00	5,000.00
50019	Tarifa të tjera administrative-Urb	2,000.00	2,000.00	2,000.00
50012	Taksa për Ndërrim të Destinimi të Tokës			
50011	Taksa për Ndërrim të Pronarit të Pronës	3,000.00	3,000.00	3,000.00
50504	Taksa për Matjen e Pronës së Paluajtshme	2,000.00	2,000.00	2,000.00
50019	Regjistrimi dhe fshirja e hipotekës			
50114	Dënimet e inspektorëve			
50505	Inspektimi veterinar			
50019	Tarifa të tjera administrative -insp			
50032	Taksa për çertifikatë të Pronësisë dhe Kopje Plani	4,657.00	4,657.00	4,657.00
40110	Tatimi ne prone	2,000.00	5,000.00	7,500.00
40110	Tatimi ne toke	8,000.00	10,308.00	13,381.00
50405	Qiradhënia e Pronës Publike	22,000.00	22,000.00	22,000.00
GJITHESEJ TE HYRAT		106,157.00	111,465.00	117,038.00

Tabela 2

PARAQITJA GRAFIKE E TË HYRAVE VETANAKE NË KAB- KOMUNAL SIPAS VITEVE 2025 – 2027



VLERËSIMET E HERËSHME TË SHPENZIMEVE TË PROGRAMEVE BUXHETORE

Në vlerësimet e herëshme të shpenzimeve buxhetore përfshihen, kornizat e shpenzimeve të secilit program buxhetor, duke u bazuar në burimet e të hyrave dhe duke u modifikuar vetëm nga treguesit makro-ekonomik dhe fiskal dhe duke pasur për bazë buxhetin e aprovuar për vitin 2024 dhe shpenzimet gjatë viteve të fundit.

Kjo kornizë paraqet parashikimin tre vjeçar të shpenzimeve të përgjithshme komunale. Të hyrat komunale janë paraqitur me një trend të rritjes për çdo vit, si dhe të granteve të qeverisë të cilat më pastaj do të inkorporohen në vlerësimet pasuese të shpenzimeve buxhetore sipas Qarkoreve Buxhetore dhe limiteve të buxhetit, të cilat do të përcaktohen në vijim të procesit të Buxhetit.

Ne vijim është një përmbledhje e ndarjeve buxhetore të kategorive ekonomike për vitin 2025 - 2027 në shpenzimet e përgjithshme.

NR.	KATEGORITË EKONOMIKE	2025	2026	2027
1	PAGA DHE SHTESA	3,403,011.00	3,503,011.00	3,735,080.00
2	MALLËRA DHE SHËRBIME	600,000.00	662,929.00	730,000.00
3	SHPENZIME KOMUNALE	130,000.00	130,000.00	150,000.00
4	SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	200,000.00	230,000.00	280,000.00
5	INVESTIME KAPITALE	2,179,356.00	2,249,356.00	2,399,356.00
	TOTALI	6,512,367.00	6,775,296.00	7,294,436.00
	STAFI	809	809	809

Tabela 3


Sqarim : Numri i stafit të OB 647 nuk është final, pasi qe këto të dhëna do të finalizohen me qarkoren buxhetore 2025/02

GRANTET QEVERTARE DHE TË HYRAT VETANAKE KOMUNALE 2025 – 2027

Më poshtë janë paraqitur Granti i Përgjithshëm, Granti Specifik i Arsimit, Granti Specifik për Shëndetësi, Financimet për Shëndetësi Sekondare , Shërbimet Rezidenciale si dhe plani i të Hyrave Vetanake Komunale sipas viteve **2025 – 2027**.

Viti	Granti i Përgjithshëm	Granti specifik për Arsim	Granti specifik për Shëndetësi	Financimi për Shëndetësi Sekondare	Shërbime Rezidenciale	Gjithsej Granti	TË HYRAT VETANAKE	TOTALI
2025	3,289,654.00	1,651,532.00	475,089.00	989,935.00	-	6,406,210.00	106,157.00	6,512,367.00
2026	3,475,115.00	1,701,078.00	497,703.00	989,935.00	-	6,663,831.00	111,465.00	6,775,296.00
2027	3,663,958.00	1,752,111.00	521,394.00	989,935.00	250,000.00	7,177,398.00	117,038.00	7,294,436.00

Tabela 4



ZYRA E KRYETARIT

Kryetar: z. Erden ATIQ

Nënkryetare: znj.Katarina ADJANCIC

Deklarata e misionit :

Misioni im si kryetar i Komunës së Mitrovicës Veriore është të udhëheq me përgjegjësi dhe transparencë për të ndërtuar një komunitet të fortë dhe të bashkuar, ku çdo qytetar ka qasje të barabartë në shërbime publike cilësore dhe mundësi për zhvillim personal dhe ekonomik. Ne angazhohemi për të përmirësuar infrastrukturën, për të promovuar arsimin dhe shëndetësinë, dhe për të nxitur një mjedis të favorshëm për bizneset dhe investimet. Me një qeverisje të drejtë dhe të hapur, synojmë të krijojmë një të ardhme më të mirë dhe më të ndritshme për të gjithë qytetarët tanë, duke respektuar dhe mbrojtur trashëgiminë tonë kulturore dhe mjedisore.

Deklarata e vizionit :

Vizioni im është që Komuna e Mitrovicës Veriore të jetë një model i zhvillimit të qëndrueshëm dhe të integruar, ku çdo qytetar ndjen siguri dhe mirëqenie. Synoj të krijoj një komunitet të bashkuar dhe të përparuar, me infrastrukturë moderne, arsim cilësor, shërbime shëndetësore të përparuara dhe mundësi të barabarta për zhvillim ekonomik. Duke promovuar transparencën, përgjegjshmërinë dhe pjesëmarrjen aktive të qytetarëve, ne do të punojmë së bashku për të ndërtuar një të ardhme më të ndritshme dhe më të begatë për brezat e ardhshëm. Me respekt për trashëgiminë tonë kulturore dhe mjedisin, do të krijojmë një ambient të favorshëm për jetë dhe punë, duke bërë Mitrovicën Veriore një vend të dëshiruar për të jetuar dhe investuar.

ZYRA E KUVENDIT KOMUNAL

Kryesues i Kuvendit Komunal: z.Nedžad UGLJANIN

Deklarata e misionit : Duke u bazuar në Ligjin për vetëqeverisje lokale, ligjet në fuqi, Statutin e Komunës, Rregulloret, udhëzimet e Kuvendit të Komunës, zyra e kuvendit duhet: Të ofroj zbatimin e tyre në mënyrë profesionale, efektive dhe efikase. Organizon punën e Kuvendit të Komunës, duke planifikuar buxhetin kujdeset për menaxhimin optimal të tij.

Kryen punët administrative dhe profesionale duke përfshirë këtu edhe punët teknike për organizimin e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, komiteteve dhe komisioneve punuese të Kuvendit të Komunës, duke përfshirë këtu edhe përpilimin e projekt-akteve që i procedohen për miratim këtyre organeve.

Punë të tjera për të gjitha organet e administratës duke përfshirë këtu pranimin e shkresave të ndryshme, dorëzimin dhe ekspeditivin e shkresave zyrtare, vërtetimin e dokumenteve dhe nënshkrimin, punët e arkivit dhe ekspeditivit.

Deklarata e vizionit : Duke menaxhuar me buxhetin e kryesuesit të Kuvendit të Komunës konform vendimit të Kuvendit të Komunës për miratimin e buxhetit dhe duke u bazuar në dispozitat e ligjeve në fuqi, duke përfshirë këtu edhe vendimet e Kuvendit të Komunës, angazhohet që qytetarëve të Komunës t'u ofrohen shërbime sa më të mira dhe më të shpejta konform detyrave dhe përgjegjësiive të Kuvendit të Komunës, duke përfshirë këtu lëshimin e dëshmimeve për Anëtarët e Kuvendit të Komunës, përpilon vendimet e Kuvendit bën ekspeditivin e akteve zyrtare e materiale për nevojat e Kuvendit të Komunës dhe Komiteteve të tij, bënë përpunimin administrativ-teknik të akteve dhe lëndëve, arkivimin e lëndëve.

DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

Drejtores: znj. Blerta ABRASHI

Deklarata e misionit :

Misioni ynë është të ofrojmë shërbime publike efikase, transparente dhe të përgjegjshme, duke siguruar që të gjitha veprimet tona të jenë në përputhje me ligjin dhe etikën profesionale.

Ne synojmë të mbështesim dhe të forcojmë komunitetet tona duke promovuar bashkëpunimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve tona në Drejtorinë e Administratës.

Jemi poashtu, të përkushtuar të ofrojmë një ambient pune gjithëpërfshirës ku të gjithë punonjësit tanë të ndihen të vlerësuar për të kontribuar në përmbushjen e nevojave dhe pritshmërive të qytetarëve tanë.

Deklarata e Vizionit :

Vizioni ynë është të bëjmë Komunën e Mitrovicës së Veriut një komunë të zhvilluar dhe të përparuar ku çdo qytetar ka mundësi të barabarta për të arritur potencialin e tij të plotë.

Në aspirojmë të krijojmë një mjedis të sigurt dhe të qëndrueshëm duke përmirësuar infrastrukturën, duke ofruar shërbime cilësore dhe padyshim duke promovuar zhvillim ekonomik dhe social.

Vizion kemi që të forcojmë lidhjet mes komuniteteve dhe të mbrojmë trashëgiminë kulturore.

DREJTORIA PËR FINANCA , BUXHET DHE ZHVILLIM EKONOMIK

Drejtores: znj. Mevlyde PECI-SHALA

Deklarata e misionit:

Misioni ynë është të sigurojmë menaxhim efikas, të përgjegjshëm dhe transparent të financave publike, të hartojmë dhe zbatojmë plane buxhetore që përmbushin nevojat e komunitetit, të nxisim zhvillimin ekonomik lokal përmes mbështetjes së biznesit dhe krijimit të mundësive të reja të punësimit, dhe të përmirësojmë cilësinë e shërbimeve publike për të gjithë qytetarët e komunës sonë. Ne angazhohemi për të ofruar transparencë dhe llogaridhënie në të gjitha proceset tona dhe për të siguruar një shpërndarje të drejtë dhe efektive të burimeve.

Deklarata e vizionit:

Vizioni ynë është të krijojmë një komunë të prosperuar dhe të qëndrueshme ekonomikisht, ku burimet financiare menaxhohen me transparencë dhe efikasitet të lartë. Ne synojmë të jemi lider në inovacionin financiar dhe zhvillimin ekonomik lokal, duke krijuar një mjedis të favorshëm për investime dhe sipërmarrje, dhe duke përmirësuar vazhdimisht cilësinë e jetës për të gjithë qytetarët tanë. Ne angazhohemi për zhvillim të qëndrueshëm që respekton mjedisin dhe për të ndërtuar një komunitet të fortë dhe të integruar ekonomikisht.

DREJTORIA PËR SHËRBIMEVE PUBLIKE , INFRASTRUKTURË , INSPEKSION DHE SITUATA EMERGJENTE

Drejtore: z. Fatir BERZATI

Deklarata e misionit:

Misioni ynë është të ofrojmë shërbime publike cilësore dhe të qëndrueshme, të mirëmbajmë dhe zhvillojmë infrastrukturën e komunës, të sigurojmë zbatimin e rregulloreve përmes inspektimeve efektive dhe të menaxhojmë me efikasitet situatat emergjente për të garantuar sigurinë dhe mirëqenien e qytetarëve tanë. Ne angazhohemi për të punuar me transparencë dhe përgjegjshmëri, duke përfshirë komunitetin në proceset tona dhe duke u siguruar që nevojat e qytetarëve të jenë gjithmonë prioriteti ynë. Përmes përmirësimit të vazhdueshëm të shërbimeve dhe infrastrukturës, synojmë të krijojmë një mjedis të sigurt, të pastër dhe të organizuar, që mbështet zhvillimin ekonomik dhe cilësinë e jetës në Mitrovicën Veriore.

Deklarata e Vizionit:

Vizioni ynë është të ndërtojmë një Komunë të Mitrovicës Veriore që ofron shërbime publike të klasit të parë, infrastrukturë moderne dhe të qëndrueshme, dhe një mjedis të sigurt dhe të mbrojtur për të gjithë qytetarët. Ne synojmë të jemi një model i ekselencës në ofrimin e shërbimeve publike dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës, duke siguruar që çdo qytetar të ketë akses në shërbime cilësore dhe të besueshme. Duke përdorur teknologjinë më të fundit dhe praktikën më të mirë, ne angazhohemi të mbikëqyrim dhe zbatojmë rregulloret në mënyrë efektive dhe transparente. Në menaxhimin e situatave emergjente, ne synojmë të jemi të përgatitur dhe të përgjegjshëm, duke siguruar një përgjigje të shpejtë dhe efektive për të minimizuar rrezikun dhe për të mbrojtur jetën dhe pronën e qytetarëve tanë. Ne punojmë për të krijuar një të ardhme më të ndritshme dhe të qëndrueshme për Mitrovicën Veriore, ku qytetarët mund të jetojnë, punojnë dhe zhvillohen në një mjedis të sigurt dhe të mirëmbajtur.

NJËSIA E ZJARRFIKËSVE

Komandant i njësisë : z. Ranko RISTOVIC

Deklarata e misionit :

Mbrojtja e jetës së njerzve, të pasurisë, të shtazëve dhe mjedisit nga zjarri. Ndërmarrja e masave dhe veprimeve për evitimin e shkaqeve të zjarrit, për pengimin e mundësisë së zgjërimit të zjarrit, zbulimin dhe fikjen e zjarrit, për vërtetimin e shkaqeve të zjarrit si dhe dhënjen e ndihmës për largimin e pasojave të shkaktuara nga zjarri.

Deklarata e Vizionit :

Mbrojtja dhe shpëtimi nga zjarri përmbanë: planifikimin organizimin, aftësimin, realizimin, mbikqyrjen, parandalimin nga zjarri, financimin e masave dhe aktiviteteve për mbrojtje nga zjarri dhe fatkeqësitë tjera.

DREJTORIA PËR URBANIZEM , KADASTËR DHE GJEODEZI

Drejtor : z. Nuhi MEHMETI

Deklarata e misionit :

Misioni ynë është të sigurojmë planifikim urban të qëndrueshëm dhe të integruar, të menaxhojmë me efikasitet dhe transparencë pasuritë e paluajtshme, dhe të përdorim teknologjinë më të avancuar në gjeodezi për të mbështetur zhvillimin e komunës sonë. Ne angazhohemi për të ofruar shërbime cilësore dhe të sakta për qytetarët dhe bizneset, duke garantuar që të gjitha projektet e zhvillimit urban dhe menaxhimit të tokës janë të bazuara në të dhëna të sakta dhe të përditësuara. Përmes transparencës dhe përfshirjes së komunitetit në proceset tona, synojmë të krijojmë një mjedis urban të organizuar, të sigurt dhe të jetueshëm. Ne jemi të përkushtuar për të mbrojtur dhe ruajtur trashëgiminë kulturore dhe mjedisore, duke siguruar një zhvillim të qëndrueshëm për të ardhmen e Mitrovicës Veriore.

Deklarata e Vizionit :

Vizioni ynë është të që Komuna e Mitrovicës Veriore të jetë e zhvilluar dhe e organizuar në mënyrë të qëndrueshme, ku çdo qytetar gëzon një mjedis urban të sigurt, të bukur dhe funksional. Ne synojmë të jemi liderë në planifikimin urban inovativ dhe të integruar, duke përdorur teknologji të avancuar gjeodezike dhe të dhëna të sakta kadastrale për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm dhe të balancuar të komunës. Me një përkushtim të thellë ndaj transparencës dhe përfshirjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse, ne synojmë të sigurojmë që të gjitha projektet dhe politikat tona të reflektojnë nevojat dhe aspiratat e komunitetit tonë. Duke mbrojtur dhe ruajtur trashëgiminë tonë kulturore dhe mjedisore, ne angazhohemi të krijojmë një të ardhme të ndritshme dhe të begatë për të gjithë qytetarët e Mitrovicës Veriore.

DREJTORIA PËR ARSIM, KULTURË, RINI DHE SPORT

Drejtores : znj. Arta AZEMI

Deklarata e misionit:

Misioni ynë është fuqizimi i të rinjve dhe krijimi i mjedisit përkrahës për zhvillimin shoqëror dhe personal të tyre, krijimin e mundësive për promovim, zhvillim dhe pjesëmarrje të të rinjve në jetën aktive shoqërore si dhe ofrimin e shërbimeve të barabarta për të rinjtë, që mundësojnë zhvillimin e shkathtësive jetësore dhe vlerave shoqërore.

Po ashtu, ndër misionet tona është edhe hartimi i politikave mbrojtëse dhe promovuese të trashëgimisë kulturore, hartimi i planeve për mbështetje kulturore, rinore dhe sportive. Shënimi i datave historike, përkrahja e asociacioneve, klubeve dhe shoqatave në aktivitetet e tyre. Gjithashtu ne synojmë të bëjmë nxitjen e investitorëve dhe kërkimin e fondeve shtesë, bashkëpunimin me qytete tjera për të mundësuar ndarjen e përvojave, bashkëpunimi me OJQ dhe organizata të tjera ndërkombëtare.

Deklarata e Vizionit:

Visioni ynë është nxitja dhe ndihmimi i artistëve dhe krijuesve të rinj për të shprehur talentet e tyre nëpërmjet ekspozitave, performancave, dhe aktiviteteve krijuese.

Përkrahja dhe promovimi i kulturave të ndryshme, organizmi i ngjarjeve kulturore dhe festivale që përfaqësojnë kulturat e ndryshme të komunitetit duke promovuar diversitetin kulturor. Mbrojta dhe promovimi i trashëgimisë kulturore. Investimi në ndërtimin e fushave sportive dhe objekteve tjera për të përmirësuar infrastrukturën sportive të komunitetit.

Organizimi i aktiviteteve sportive dhe programet shëndetësore që inkurajojnë komunitetin të jetë më aktiv dhe të kujdeset për shëndetin e tyre. Inkurajimi i pjesëmarrjes së komunitetit në aktivitete kulturore, sportive dhe rinore, duke organizuar takime të hapura për të dëgjuar dhe për të marrë sugjerime nga qytetarët.

Ndërtimi i partneriteteve me organizatat e tjera për të arritur qëllimet e përbashkëta dhe për të shfrytëzuar burime të përbashkëta për të financuar dhe implementuar projekte. Investimet në modernizimin e mesimdhënis duke përdorur teknologjine janë fokusi ynë.

DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE SHËRBIME SOCIALE

Drejtores: Znj. Milica FILIPOVIC

Drejtor i Q.P.S. Dejan DJINOVIC

Deklarata e misionit:

Qendra për Punë Sociale në Mitrovicën Veriore ka për qëllim t'u ofrojë të gjithëve ndihmën e nevojshme, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre fetare dhe kombëtare. Ndihma dhe fuqizimi i familjeve të rrezikuara, në mënyrë që ato të eliminojnë rrethanat negative të jetës, të cilat pa ndihmën profesionale të punonjësve socialë, vështirë se mund t'i zgjidhin vetë.

Deklarata e Vizionit:

Vizioni ynë është që komuna e Mitrovicës së Veriut të jetë një nga komunat më të zhvilluara që çdo qytetar të ketë mundësi dhe të drejta të barabarta.

Shërbimet shëndetësore të jenë cilësore, të sigurta, efikase, të bazuara në parimet e humanizmit dhe profesionalizmit, si dhe lehtësisht të qasshme për qytetarët dhe për t'i udhëzuar ata për trajtim të mëtejshëm.

DREJTORIA PËR KOMUNITETE LOKALE DHE KTHIM

Drejtor: z. Jeton RRAHMANI

Deklarata e misionit:

Qëllimi kryesor i Drejtorisë për Komunitete Lokale Kthim në Komunën e Mitrovicës Veriore është të kontribuojë në zhvillimin e përgjithshëm të të gjitha komuniteteve të Komunës, duke mos bërë dallime në mes tyre. Drejtoria Lokale për Komunitete dhe Kthim i dedikohet shërbimit të komuniteteve joshumicë për realizimin e të drejtave të tyre, të parapara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjeve në fuqi. Promovimin e barazisë dhe mos diskriminimit si në nivelet lokale ashtu edhe në ato qendrore. Kjo drejtori funksionon për të zgjedhur dhe adresuar nevojat e pjesëtarëve të ktyre komuniteteve dhe strukturat institucionale përgjegjëse.

Deklarata e qëllimit:

Përmban synimin për gjithëpërfshirjen dhe avancimin e të gjitha komuniteteve në shoqërinë kosovare, duke i motivuar ata të jetojnë dhe të kontribuojnë në Komunën e Mitrovicës Veriore. Përfshirja e tyre në aktivitete të ndryshme kulturore, sportive, dhe sociale është një pjesë e këtij qëllimi. Përmes kësaj gjithëpërfshirjeje, Komuna e Mitrovicës Veriore synon të sigurojë një nivel të barabartë të shërbimeve për të gjitha komunitetet, pa dallim nëse janë shumicë apo joshumicë në qytet.

Shënim:

Drejtoria për Buxhet dhe Financa mban të drejtën të bëjë plotësim - ndryshime në çdo kohë deri të bëhet aprovimi në Kuvend Komunal , sa i përket Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitet 2025-2027 varësisht nga udhëzimet e Qarkoreve Buxhetore e lëshuara nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve .